

Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

## RAPORT ME REKOMANDIM I AVOKATIT TË POPULLIT

Ankesa nr. 108/2019

kundër

Policisë së Kosovës

*lidhur me kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike*

Drejtuar: Z. Rashit Qalaj, Drejtor i Përgjithshëm  
Policia e Kosovës

Kopje: Znj. Taibe Canolli Brajshori, Drejtor  
Departamenti për Burime Njerëzore, Policia e Kosovës

Prishtinë, më 22 korrik 2019

## Qëllimi i Raportit

1. Qëllim i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Policisë së Kosovës lidhur me ankesën e A. N. (ankuesi) për qasje në dokumente publike; analizimi i Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP); detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse në raport me zbatimin e këtij ligji në rastet e pranimin të kërkesave për qasje në dokumente publike. Raporti bazohet në faktet, provat, si dhe nga shkresat e lëndës, të cilat i ka Institucionit i Avokatit të Popullit (IAP).

## Baza kushtetuese dhe ligjore

2. Sipas nenit 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
3. Gjithashtu, Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, me përgjegjësitë e përcaktuara me nenin 18, paragrafët 1, 2, 4, 5, 6 dhe 8.

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit synon që t'i kryejë këto përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore.

## Përshkrimi i çështjes

Dëshmitë dhe informatat të cilat i ka Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), të ofruara nga ankuesi dhe të evidentuara nga hetimi i bërë lidhur me rastin, përmbledhen si në vijim:

4. Ankuesi kishte aplikuar në konkursin e shpallur nga Policia e Kosovës për zyrtarë policorë, i datës 26 prill 2018 (nr. i Aplikacionit 05/01254), në të cilin ishte renditur i 73-ti, sipas pikëve të fituara (87.80). Më 30 nëntor 2018, ankuesi i është nënshtruar testit psikologjik dhe testit mjekësor në klinikën e autorizuar për këtë qëllim. Pas publikimit të listës nga Komisioni Përzgjedhës për Menaxhimin e Procesit të Rekrutimit (Komisioni), ka rezultuar se ankuesi ka dështuar në kontrollin mjekësor. Më 31 dhjetor 2018, ka parashtruar ankesë në Komision. Komisioni përzgjedhës për procesin e rekrutimit dhe seleksionimit për policë, ka nxjerrë vendim, më 4 janar 2019, me ç' rast e ka refuzuar ankesën si të pabazuar, duke konstatuar se në fazën së kontrollimit mjekësor ka dështuar t'i përmbushë kriteret e përcaktuar në Procedurën Standarde të Operimit nr. PSO-5.07.
5. Më 15 janar 2019, ankuesi, nëpërmjet postës elektronike, i është drejtuar PK-së me kërkesë për qasje në dokumentet e kontrollit mjekësor, respektivisht për qasje në raportin e mjekut specialist për shëndetin e tij.
6. Më 25 janar 2019, ankuesi ka marrë përgjigje me të cilën i refuzohet kërkesa për qasje, me arsyetimin: *“[...] të gjitha rezultatet dhe vlerësimet e testit psikologjik-kontrollit mjekësor janë të dhëna të klasifikuara dhe duhet të mbahen konfidenciale[...].”*
7. Më 13 shkurt 2019, bazuar në nenin 10 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP), ankuesi ka parashtruar ankesë në IAP kundër Policisë Kosovës, për shkak të kufizimit për qasje në dokumente publike.
8. Më 6 mars 2019, Avokati i Popullit, përmes shkresës, iu drejtua shefit të Zyrës për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun i PK-së, nëpërmjet të cilës kërkoi informata për veprimet që do të ndërmerren, në mënyrë që çështja e ankuesit të trajtohet në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

9. Më 18 mars 2019, Avokati i Popullit mori përgjigje nga drejtori i Përgjithshëm i PK-së, përmes së cilës e njoftoi për veprimet që janë ndërmarrë lidhur me kërkesën e ankuesit.

### **Instrumentet ligjore të zbatueshme në Kosovë**

10. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në nenin 41, paragrafi 1, parasheh të drejtën për qasje në dokumente publike, sipas të cilit definohet: *“Secili person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike.”*
11. Paragrafi 2, i po të njëjtit nen të Kushtetutës, përcakton se dokumentet e mbajtura nga të gjitha institucionet janë të qasshme për të gjithë, me përjashtim të atyre dokumenteve qasja në të cilat është e kufizuar me ligj: *“Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.”*
12. E drejta për t'u informuar është e drejtë e garantuar me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 19 i së cilës përcakton: *“Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë.”*
13. Lirinë për të marrë dhe për të dhënë informacion e parasheh edhe neni 10, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) - [Liria e Shprehjes]: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë...”*
14. Fryma e nenit 41 të Kushtetutës është përcjellë edhe në nenin 1 të LQDP-së, sipas të cilit: *“Ky ligj garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike.”*
15. Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke proklamuar parimin e administratës së hapur, në nenin 9, paragrafi 1, parasheh: *“Organet publike duhet të veprojnë me transparencë.”*
16. Avokati i Popullit vlerëson se përjashtimet e së drejtës së qasjes në dokumente janë të përcaktuara në nenin 12 të LQDP-së. Ndërsa informacionet mund të kufizohen vetëm për qëllime të mbrojtjes së interesave legjitime publike, të jetës ose të interesave të tjera legjitime private, të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe me Ligjin për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë.

### **Analiza e rastit dhe konstatimet e Avokatit të Popullit**

17. Avokati i Popullit vëren se kërkesa e ankuesit për qasje në dokumente publike, e datës 13 shkurt 2019, drejtuar PK-së, ka të bëjë me qasjen në të dhënat e tij personale, të cilat janë mbledhur/krijuar gjatë procedurës së rekrutimit për pozitën e shpallur nga PK-ja.
18. Përkitazi me këtë, LQDP-ja, në nenin 12, paragrafi 1, shprehimisht i përcakton situatat për refuzimin e së drejtës për qasje në dokumente; dhe në paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet mundësia kur pjesët e mbetura të dokumentit bëhen publike, nëse vetëm një pjesë e dokumenteve të kërkuara përfshihen nga ndonjë prej përjashtimeve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

19. Ndërsa Ligji nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP)<sup>1</sup>, në nenin 22, e përcakton të drejtën e subjektit të të dhënave, të cilat përpunohen nga kontrolluesi i të dhënave, në rastin konkret nga PK-ja, respektivisht kërkuesi i dokumentit, bazuar në këtë dispozitë, ka të drejtë për qasje të plotë në të gjitha të dhënat personale të tij. Neni 23 i LMDhP-së i përcakton detyrat dhe obligimet e kontrolluesit, në rastin në fjalë të PK-së, që për çfarëdo informacioni të kërkuar nga subjekti i të dhënave duhet t'i lejohet qasja e plotë.
20. Në praktikën e GjEDNj-së, mbrojtja e të dhënave garantohet nga neni 8 i KEDNj-së [E drejta për respektim të jetës private dhe familjare], duke qenë se kjo e drejtë nuk është e drejtë absolute, ajo duhet të ekuilibrohet me të drejtat e tjera. Sa i përket rastit në fjalë, ankuesi ka kërkuar qasje në rezultatet e testit mjekësor, të cilit i është nënshtruar në njërin nga fazat e procesit rekrutues, në bazë të të cilit Komisioni ka vlerësuar se ankuesi ka dështuar në kontrollin mjekësor. E drejta e ankuesit për qasje në të dhënat që mbahen nga një autoritet publik/shtetëror hyn në fushëveprimin e nenit 8 të KEDNj-së, duke qenë se bëhet fjalë për të dhëna shëndetësore që i përkasin ankuesit/kërkuesit të dokumentit.
21. GjEDNj vlerëson se është parim thelbësor respektimi i të dhënave konfidenciale për të dhënat shëndetësore.<sup>2</sup> Rëndësia e saj rivendos jo vetëm të drejtën e individit për privatësi, por edhe besimin e tij/saj në profesionin mjekësor dhe për shërbimet shëndetësore në përgjithësi.
22. Në rastin *Gaskin kundër Mbretërisë së Bashkuar*<sup>3</sup>, kërkuesi kishte kërkuar qasje në të gjithë dosjen që kishin lidhje me kohën që ai kishte kaluar nën kujdesin e shtetit dhe e kishte sfiduar pamundësinë për t'i dhënë atij qasje në këto të dhëna, duke e konsideruar si dështim për të respektuar jetën e tij private, sipas nenit 8 të KEDNj-së. Gjykata, meqenëse të dhënat që përmbante dosja i përkisnin jetës private dhe familjare të kërkuesit, kishte konsideruar se çështja binte nën përcaktimet e nenit 8 të KEDNj-së. Më pas ajo kishte vijuar të vlerësonte nëse ishte vendosur një ekuilibër i drejtë midis interesit të përgjithshëm të komunitetit në mbajtjen e sistemit konfidencial të regjistrave të shërbimeve sociale dhe interesave të individit për qasje ndaj informacionit që kishte të bënte me jetën e tij private. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata vërejti se personat si kërkuesi kanë një "interes jetik" në marrjen e informacionit që është i nevojshëm [...].
23. Në analogji me këtë, Avokati i Popullit vëren se refuzimi i kërkesës së ankuesit për qasje në rezultatet e testit mjekësor, të cilit i është nënshtruar në njërin nga fazat e procesit rekrutues, në bazë të të cilit Komisioni ka vlerësuar se ankuesi ka dështuar në kontrollin mjekësor, përbën shkelje të nenit 8 të KEDNj-së. Në rastin e ankuesit nuk bëhet fjalë për qasje në të dhënat e një personi të tretë, por për vetë ankuesin, i cili, bazuar në këto të dhëna, është diskualifikuar nga procedura e rekrutimit për zyrtar policor.
24. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit konstaton se refuzimi i kërkesës së ankuesit për qasje në raportin mjekësor në dosjen e tij si kandidat në procedurën e rekrutimit për zyrtar policor ia mohon ankuesit të drejtën për qasje në dokumente publike, e drejtë kjo e garantuar me Kushtetutë dhe me ligj.

<sup>1</sup> Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka hyrë në fuqi më 12 mars 2019 dhe ka shfuqizuar Ligjin nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

<sup>2</sup> Z kundër Finlandës, aktgjykimi i 25 shkurtit 1997.

<sup>3</sup> Gaskin kundër Mbretërisë së Bashkuar, aktgjykimi i 7 korrikut 1989.

Së këndejmi, me qëllim të përmirësimit të respektimit të së drejtës për qasje në dokumente publike, si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, në mënyrë që qytetarët ta shfrytëzojnë këtë të drejtë si mjet të fuqishëm për kontrollin e punës së organeve të pushtetit, e që do të ndikonte në përmirësimin e punës së organeve shtetërore dhe rritjen e transparencës dhe të llogaridhënies, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i


## REKOMANDON

### Polici së Kosovës:

- Në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike, t'i ofrojë ankuesit qasje në raportin mjekësor në dosjen e tij.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi që të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,



Hilmi Jashari

Avokat i Popullit